

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6972  
E premte, 18 gusht 2023  
Çmimi 0.40 €

Dëshmitarja serbe në  
Hagë e pranon se civilët  
serbë ishin armatosur  
nga Serbia | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

BASHKIMIT EVROPIAN (BE) NUK I MJAFTON TËRHEQJA E NJË PJESE  
TË POLICISË SË KOSOVËS NGA VERIU | FAQE 4-5

## BRUKSELI DO HAPA TË TJERË NGA QEVERIA KURTI PËR SHTENSIONIMIN E SITUATËS NË VERI



Bashkimi Evropian (BE) ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të ndërmarrë hapa të tjerë që do të çonin në shtensionimin e situatës në veri të vendit. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka thënë se këta hapa duhet të

përfshirjen edhe në mbajtjen e zgjedhjeve në katër komunitat në veri të Kosovës. "Në mënyrë që të zbutet kriza aktuale, kemi thënë shumë shpesh, zgjedhjet e parakohshme duhet të mbahen sa më shpejt që të jetë

e mundur në të katër komunitat. Ato duhet të organizohen në mënyrë gjithëpërfshirëse. Kjo nënkupton pjesëmarrjen e plotë dhe të pakushtëzuar të serbëve të Kosovës", ka thënë Stano

### OPINION

ALBIN KURTI, ADHURUES  
"I FLAKTË" I ARIF ZIBERIT  
DHE GRUPIT "ELITA 5" | F. 7

Shkruan:  
Behxhet Sh. SHALA  
- BAJGORA



### AKTUALE



BESNIK MUJECIT DHE KATËR TË  
TJERËVE U CAKTOHET MASA E  
BURGIMIT PA AFAT | F. 3

MAQEDONCI, I NGAZËLLYER ME  
PUNËN NË MINISTRINË E  
MBROJTJES DHE FSK-së | F. 5

ZËVENDËSMINISTRJA E JASHTME  
DËNOHET ME 500 EURO GJOBË | F. 3

BAJRAKTARI PËRZGJEDHET PËR TA  
NDJEKUR AKADEMINË USHTARAKE  
MBRETËRORE NË SANDHURST | F. 5


### EKONOMI



MURATI: MBI 740 MILIONË EURO  
BUXHET PËR KOMUNAT  
PËR VITIN 2024 | F. 8

SA FITOJNË KOMPANITË E  
DERIVATEVE TË NAFTËS? | F. 8

KURTI ME  
KRYESUESIN  
E KGJK-së  
DISKUTOJNË  
PËR SISTEMIN  
GJYQËSOR | FAQE 3



SHBA-ja DHE  
EULEX-i, TË  
SHQETËSUAR PËR  
DORËHEQJET E  
POLICËVE SERBË | FAQE 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Arrestohet ish-zëvendësministri i Shëndetësisë në Shqipëri

**TRANË, 17 GUSHT** - Me urdhër të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK), në Shqipëri është arrestuar ish-zëvendësministri i Shëndetësisë, Klodjan Rrjepaj. Ai është vënë në pranga në kuadër të hetimit për koncesionin e sterilizimit të pajisjeve mjekësore. Gjithashtu, është arrestuar edhe Ilir Rrapaj, biznesmeni që fitoi këtë koncesion.

Për të njëjtën çështje penale është caktuar masat e sigurisë "detyrim për paraqitje" për Arben Gjatën, aktualisht shef i Repartit të Kirurgjisë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe rektor i Universitetit të Mjekësisë. Mësohet se masat e kërkuara nga SPAK-u janë për akuzat e "shpërdorimit të detyrës" dhe

"falsifikimit të dokumenteve", ndërsa ende nuk ka njoftim zyrtar për mediet.

Për këtë çështje të enjten është marrë në pyetje ish-ministri i Financave, Shkëlqim Cani. Mësohet se ai është thirrur për të dhënë shpjegime në lidhje me një shkresë të firmosur nga Ministria e Financave më 2015, që ka lidhje me këtë tender. Ministria e Shëndetësisë lidhi në fund të vitit 2015 një kontratë koncesionare me kompaninë "Sani Service" për 100 milionë dollarë "për shërbime të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e



mbetjeve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale".

Kontrata koncesionare u lidh për një periudhë 10-vjeçare. Koncesioni i sterilizimit të pajisjeve mjekësore është kallëzuar në SPAK nga shoqëria civile, konkretisht nga Nisma "Thurje", katër vjet më parë.

Në kallëzimin e përfaqësuesve të nismës "Thurje" theksohej se zyrtarët publikë, të përfshirë në dhënien e tenderit, "mund të kenë kryer veprat penale: shpërdorim detyre, shkelje e barazisë së pjesëmarrjes në tenderë dhe/ose korrupsionin pasiv, duke përdorur pushtetin publik për përfitim private".

Ky ka qenë kallëzimi i parë që është depozituar në SPAK pas ngritjes së këtij institucioni të drejtësisë në nëntor 2019. Për këtë çështje është pyetur edhe Ilir Beqja, i cili në kohën që u firmos kontrata, ka qenë ministër i Shëndetësisë.

Sipas kontratës me Ministrinë e Shëndetësisë, për 10 vjet qeveria shqiptare do t'i paguajë koncesionarit 100 milionë euro.

Por, tejkalimi i kostove dhe shkeljet janë konstatuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit që në vitet e para të zbatimit.

Në vitin 2018 Ministria e Shëndetësisë urdhëroi spitalet t'i reduktojnë operacionet.

Ministrja e Shëndetësisë nuk e ka mohuar, por ka folur për racionalizim të ndërhyrjeve. "Nuk ka asnjë urdhër, ka vetëm racionalizim, optimizim, siguri për qytetarët", kishte deklaruar në atë kohë ministrja Ogerta Manastirliu.

Përveç koncesionit të sterilizimit, në SPAK janë dorëzuar kallëzime edhe për dy koncesione të tjera në shëndetësi, konkretisht "kontrolli shëndetësor falas" (check Up) si dhe "hemodializa".

## Stoltenbergu: Nuk ka ndryshim të qëndrimit bërthamor të Rusisë



**Bruksel, 17 gusht** - NATO nuk ka vërejtur ndonjë ndryshim të forcat bërthamore të Rusisë, ka thënë shefi i aleancës ushtarake perëndimore, Jens Stoltenberg. "Ne nuk kemi parë asnjë ndryshim në forcat e tyre bërthamore që do të na xistë t'i ndryshonim forcat tona. Deri më tani nuk kemi parë asgjë që do të kërkonte që pala jonë të ndërmarrë diçka", ka thënë Stoltenbergu.

Në një konferencë për medie në Arendal të Norvegjisë, Stoltenbergu ka folur edhe për bisedimet e paqes të Ukrainës.

Ai ka thënë se është në dorën e Ukrainës që të vendosë nëse kushtet janë të duhurat për t'iu bashkuar çdo negociatë pas nisjes së pushtimit nga Rusia. "Janë ukrainasit, vetëm ukrainasit që mund të vendosin nëse ka kushte për negociatë, kush mund të vendosë gjatë negociatave si dhe

cila do të jetë një zgjidhje e pranueshme", ka thënë Stoltenbergu.

Më tutje, ai ka theksuar se roli i NATO-s është që ta mbështesë Ukrainën. Deklarata e shefit të NATO-s vjen pasi disa ditë më parë shefi i stafit të tij, Sian Jenssen, deklaroi se Ukraina në fund ndoshta do t'i japë territor Rusisë si pjesë e një marrëveshjeje për t'i dhënë fund luftës. Jenssen më vonë deklaroi se i vjen keq për

komentet e bëra.

Në samitin e fundit të NATO-s, të mbajtur muajin e kaluar, aleanca tha se do t'i dërgojë ftesë Ukrainës për t'iu bashkuar aleancës "kur shtetet anëtare të pajtohen se janë plotësuar kushtet". Mijëra trupa ukrainase po stërviten nga partnerët perëndimorë të Kievit dhe Ukraina varet shumë nga furnizimet me armatime nga Perëndimi në luftën e saj kundër Rusisë.

## Mbi 60 emigrantë dyshohet se kanë vdekur në brigjet afrikane

**KEJP VËRD, 17 GUSHT** - Më shumë se 60 persona dyshohet se kanë vdekur pas gjetjes së një anijeje në brigjet e shtetit Kejp Vërd në Afrikën Perëndimore. Në pamjet e publikuara në media është parë se 39 persona, përfshirë fëmijë, janë shpëtuar në ishullin Sal. Pothuajse të gjithë personat që kanë qenë në anije, e cila besohet se ka qenë në det për një muaj, kanë qenë nga Senegali.

Zyrtarë të Kejp Vërdit kanë bërë thirrje për veprim global për migrimin, ashtu që të

parandalohet humbja e mëtejme e jetës së njerëzve.

Anija është identifikuar fillimisht të hënën, ka thënë policia shtetërore për agjencinë e lajmeve "AFP".

Fillimisht ka pasur raportime se ajo është përmbetur, por më vonë ajo është parë duke lëvizur. Ministria e Jashtme e Senegalit ka thënë të martën se anija është larguar prej një fshati të Senegalit më 10 korrik me 101 persona në të.

Të mbijetuarit mund të kenë përfunduar në Kejp Vërd,



mirëpo ky shtet besohet se nuk ka qenë destinacioni i tyre. Ky

shtet gjendet rreth 600 kilometra larg rrugës që bëjnë emigrantët

drejt Ishujve Kanare, territor spanjoll, i cili për shumë emigrantë është rrugë drejt Bashkimit Evropian.

Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migrantë (IOM), kjo është një prej rrugëtimeve më të rrezikshme që mund ta bëjnë migrantët.

Shifrat e sakta nuk dihen për shkak të migrimit të parregullt, mirëpo besohet se në periudhën 2020-2023, të paktën 67 000 persona kanë shkuar në Ishujt Kanare. Në të njëjtën periudhë, mbi 2 500 persona kanë vdekur.

## Anulohen dhjetëra fluturime si pasojë e stuhisë në Frankfurt

**Frankfurt, 17 gusht** - Dhjetëra fluturime janë anuluar në Aeroportin e Frankfurtit në Gjermani si pasojë e shiut të madh që i ka vërshuar disa pjesë të pistës.

Një zëdhënës i aeroportit ka thënë të enjten për agjencinë e

lajmeve "DPA", se akumulimi i madh i ujit në disa pjesë të aeroportit, në pistë, në zonën ku parkohen aeroplanët, dhe ku bëhen gati për fluturime, i ka detyruar autoritetet që shumë fluturime t'i anulojnë, apo t'ua ndërrojnë orarin. Shërbimet

tokësore në aeroportin më të madh të Gjermanisë janë pezulluar për më shumë se dy orë, çka nënkupton që më shumë se 34 aeroplanë nuk kanë mundur të nisen me kohë në destinacionet e tyre. Shumë fluturime janë anuluar edhe prej

vetë kompanive ajrore. Shërbimi Gjerman për Motin e ka lëshuar të mërkurën një paralajmërim për stuhi për gjithë landin Hesen, ku gjendet Frankfurti. Ka pasur raportime për vërshime të izoluara në shumë bodrume të banesave të atij landi.



## Zëvendësministrja e Jashtme dënohet me 500 euro gjobë



PRISHTINË, 17 GUSHT - Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Liza Gashi, është dënuar me 500 euro gjobë pasi është shpallur fajtores se ka deklaruar me vonesë pasurinë. Fillimisht, gjykata më 15 qershor të 2022-s ka pranuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë aktakuzën ndaj Gashit për veprën penale "Mosraportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve

financiare". Gashi në cilësinë e zëvendësministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, edhe pse ka qenë e njoftuar përmes vendimit për emërim nga kryeministri Albin Kurti si dhe nga zyrtarja kontraktuese brenda ministrisë, e njëjta deklarimin e pasurisë e ka bërë me vonesë, raporton "Betimi për Drejtësi". Gjykatësi Eroll Gashi, pasi ka shqyrtuar aktakuzën dhe shkresat e lëndës, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë për

dhënien e urdhrin ndëshkimor. Gjykata, po ashtu, ka sqaruar në vendimin e saj se dënimi i shqiptuar me gjobë prej 500 eurosh ndaj Gashit është vendim meritor dhe vendim përmes të cilit do të parandalohet të akuzuarën Gashi që të kryejë vepra të tjera penale në të ardhmen. Për mosdeklarim të pasurisë ishte dënuar edhe ministrja për Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, Rozeta Hajdari, me 700 euro gjobë më 29 dhjetor 2022.

## Besnik Mujecit dhe katër të tjerëve u caktohet masa e burgimit pa afat

Tiranë, 17 gusht - Gjykata Penale e Tiranës ka caktuar burgim pa afat për pesë të arrestuarit e operacionit antidrogë, ku janë sekuestruar 11 300 doza ekstazi - i përfshirë edhe asamblisti i Vetëvendosjes, Besnik Mujeci. Arrest në burg i caktuar edhe për Mithat Ramadani, Besnik Mujeci, si dhe për Kalem Picari, Ambra Myftari dhe Daniel Avdia. Gjyqtari ka pranuar kërkesën e prokurorit që pesë të arrestuarit të vijojnë të hetohen

në qeli. Mujeci ishte në mesin e pesë të arrestuarve në Tiranë nën dyshimin për trafikim droge. Dozat e gjetura, sipas policisë, kapin vlerën prej 400 mijë eurosh. Sipas Policisë së Shqipërisë, Mujeci është në mesin e pesë të arrestuarve në Tiranë nën dyshimin për trafikim droge. Në njoftimin e policisë është thënë se ky grup u kap me mbi 11 mijë doza droge në vlerë prej 400 mijë

eurosh. Besnik Mujeci, asamblisti i Lëvizjes Vetëvendosje, i arrestuar në Shqipëri nën dyshimin për trafikim droge, është përjashtuar nga të gjitha strukturat e partisë. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, kishte deklaruar se veprimet për të cilat është arrestuar Besnik Mujeci janë krime të rënda dhe se institucionet e drejtësisë ndaj tij dhe të tjerëve duhet ta shqiptojnë dënimin e merituar.



## Dëshmitarja serbe në Hagë e pranon se civilët serbë ishin të armatosur nga Serbia

HAGË, 16 GUSHT - Dëshmitarja e 17-të me radhë, Dragica Bozhaniq, e cila në kohën e luftës jetonte në një zonë të Rahovecit, ka përfunduar dëshminë e saj në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, duke thënë se, pas asaj që ka ndodhur në luftë, nuk do të kthehet asnjëherë për të jetuar në Kosovë.

Bozhaniq ka thënë se nuk ia uron askujt atë që ka përjetuar. Sipas saj, gjysma e zemrës i është humbur kur ia kanë rrëmbyer djalin 16-vjeçar nga dora dhe se i



është shkaktuar një dhimbje e madhe. Ajo ka thënë se nuk do të ndalojë asnjëherë derisa ta zbulojë të vërtetën. Në vazhdim të seancës,

dëshmitarja është përgjigjur edhe në pyetjet e mbrojtësit të viktimave, Simon Laws. Më tuje, avokati i Hashim Thaçit, Gregory Kehoe, e ka pyetur dëshmitaren

nëse burrat e fshatit të saj ishin të armatosur me armë. Ajo është përgjigjur "po". Po ashtu, kur është pyetur se a është e saktë të thuhet se autoritetet serbe u kanë dhënë armë civilëve në fshatra të ndryshme të Kosovës, Bozhaniq ka thënë po por, sipas saj, kjo ka ndodhur para se të ndodhte ngjarja. "Armët janë shpërndarë për burrat", ka thënë dëshmitarja serbe. Ajo ka thënë se burri i saj nuk kishte pasur armë, përveç një pistolette që e kishte blerë, as edhe djali i saj që kishte qenë i vogël.

Gjatë muajit prill ka filluar gjykimi, ndërsa në seancën e 3 prillit Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe mbrojtësi i viktimave kanë paraqitur deklaratimet hyrëse dhe pas leximit të aktakuzës së ndryshuar nga ana e ZPS-së, ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentari Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, si dhe ish-deputeti Rexhep Selimi janë deklaruar të pafajshëm për veprat penale që u vihen në barrë. Liderët e UÇK-së janë duke u mbajtur në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020.

## Kurti me kryesuesin e KGjK-së diskutojnë për sistemin gjyqësor

Prishtinë, 17 gusht - Kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj. Siç njofton qeveria, tema të takimit të tyre ishin planifikimet e Këshillit Gjyqësor për efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit gjyqësor, rezultatet e deritanishme të

Gjykatës Komerciale pas funksionalizimit të saj, reformat në drejtësi dhe funksionimi i Gjykatës në Mitrovicën e Veriut. "U dakorduan për intensifikimin e bashkëpunimit rreth reformës në drejtësi, si dhe çështjeve të tjera, të cilat kanë të bëjnë me forcimin e sundimit të ligjit", ka njoftuar

qeveria. Në këtë takim kryeministri Kurti ishte i shoqëruar nga ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu dhe zëvendësministri Blerim Sallahu, ndërkaq nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përveç kryesuesit, e pranishme ishte edhe anëtarja e KGjK-së, Drita Rexhaj.









BASHKIMIT EVROPIAN (BE) NUK I MJAFTON TËRHEQJA E NJË PJESE TË POLICISË SË KOSOVËS NGA VERIU

# Brukseli do hapa të tjerë nga qeveria Kurti për shtensionimin e situatës në veri

Bashkimi Evropian (BE) ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të ndërmarrë hapa të tjerë që do të çonin në shtensionimin e situatës në veri të vendit. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka thënë se këta hapa duhet të përfshirjen edhe në mbajtjen e zgjedhjeve në katër komunat në veri të Kosovës. “Në mënyrë që të zbutet kriza aktuale, kemi thënë shumë shpesh, zgjedhjet e parakohshme duhet të mbahen sa më shpejt që të jetë e mundur në të katër komunat. Ato duhet të organizohen në mënyrë gjithëpërfshirëse. Kjo nënkupton pjesëmarrjen e plotë dhe të pakushtëzuar të serbëve të Kosovës”, ka thënë Stano

**EPOKA  
ERE**

Lirim GECI

**BRUKSEL, 17 GUSHT** - Blloku evropian ka mirëpritur vendimin e Qeverisë së Kosovës për ta zvogëluar praninë e policisë në dhe përreth komunave në veri të Kosovës të banuar me shumicë serbe. Në një konferencë për medie, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka thënë se duhen edhe hapa të tjerë që do të çonin në shtensionimin e mëtejshëm të situatës në veri, përfshirë mbajtjen e zgjedhjeve të reja. “Këta janë hapa të rëndësishëm në drejtimin e duhur, por nevojiten hapa të tjerë. Sikurse çdo gjë në dialog, afatet kohore nuk janë në dorën tonë. Afatet kohore varen nga aftësia e palëve për t’i përmbushur kërkesat e nevojshme, kriteret apo zotimet. Në mënyrë që të zbutet kriza

aktuale, kemi thënë shumë shpesh, zgjedhjet e parakohshme duhet të mbahen sa më shpejt që të jetë e mundur në të gjitha katër komunat. Ato duhet të organizohen në mënyrë gjithëpërfshirëse. Kjo nënkupton pjesëmarrjen e plotë dhe të pakushtëzuar të serbëve të Kosovës”, ka thënë Stano.

Stano ka thënë se për bllokun evropian, si ndërmjetësues i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e raporteve, është shumë e rëndësishme që ky proces të rinisë në mënyrë që palët të mund të trajtojnë çështje të rëndësishme. “Dhe çështje më e rëndësishme është marrëveshja e Ohrit, por dhe aneksi i saj”, ka thënë Stano, duke iu referuar marrëveshjes së arritur në Bruksel në shkurt, dhe aneksit të saj të arritur në Ohër një muaj më

pas. Kjo marrëveshje synon t’i shtyjë palët drejt normalizimit të plotë të raporteve.

Ndërsa ambasadori i ShBA-së, Jeffrey Hovenier, të mërkurën në një takim me gazetarë ka thënë se mbajtja e zgjedhjeve në katër komunat veriore të banuara me shumicë serbe është një nga pikat që është identifikuar nga BE-ja si diçka që mund ta shtensionojë situatën në këtë pjesë të vendit dhe se ShBA-ja pajtohet me këtë kërkesë. “Jemi të shqetësuar sa i përket situatës në veri të Kosovës dhe i kemi kërkuar qeverisë të marrë masa. I kemi kërkuar edhe Qeverisë së Serbisë të marrë masa për ta arritur shtensionimin në veri të Kosovës. Ne duam t’i shmangim trazirat, kërcënimet e dhunën dhe gjëra të tjera të cilat pengojnë aftësinë tonë për të punuar me palët për t’u

fokusuar në objektivat strategjike, që është zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit nga të dyja palët”, ka thënë ambasadori amerikan.

Më tutje, Hovenieri ka thënë se Kosova është zotuar se do t’i përmbushë pikat e rena dakord mes kryenegociatorit të Kosovës, Besnik Bislimi, dhe emisarit evropian Miroslav Lajçak, në Bratislavë, për shtensionimin e situatës në veri, dhe se ShBA-ja e mirëpret dhe e sheh këtë si hap pozitiv drejt shtensionimit. “Pyetja se si do të mbahen zgjedhjet në veri është pyetje e brendshme për Kosovën. Se a bëhet kjo përmes dorëheqjes së kryetarëve të komunave, ose nëse bëhet përmes një procesi ku votuesit votojnë për t’i larguar kryetarët aktualë (peticioni)... Ne jemi të interesuar vetëm ta shohim procesin që po ecën para”, ka thënë Hovenieri, duke shtuar se ShBA-ja pret që serbët që jetojnë në veri, kësaj radhe të marrin pjesë në zgjedhje.

Duke folur për kryetarët aktualë të komunave në veri - të cilët ka thënë se ShBA-ja i njeh si të ligjshëm pa marrë parasysh mënyrën se si është zhvilluar situata më pas - ai ka theksuar se mendon se asnjë kryetar i zgjedhur me më pak se 4 për qind të votave “mund të ndihet

se ka mandat gjithëpërfshirës”. Më 10 korrik Kosova dhe Bashkimi Evropian janë pajtuar për disa hapa për shtensionimin e situatës, përfshirë zvogëlimin e pranisë policore dhe organizimin e zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore. Megjithatë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se zgjedhjet e reja në veri nuk mund të mbahen pa shtensionimin e plotë të situatës.

Tensionet në veri janë rritur në maj të këtij viti, pasi kryetarët e rinj shqiptarë, nën përcjelljen e Policisë së Kosovës, hynë në ndërtesat komunale. Serbët lokalë kundërshtojnë kryetarët e rinj, që kanë dalë nga zgjedhjet e prillit, të cilat u bojkotuan nga partitë serbe dhe banorët serbë. Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara vazhdimisht kanë kërkuar nga Kosova ta shtensionojë situatën, duke tërhequr policinë dhe që kryetarët të mos punojnë nga ndërtesat komunale. Nga Serbia është kërkuar t’i inkurajojë serbët që të marrin pjesë në zgjedhjet e reja.

Si pasojë e mospërmbushjes së kërkesave, BE-ja po zbaton disa masa ndëshkuese ndaj Kosovës, të cilat ka thënë se do t’i heqë kur Prishtina t’i plotësojë kërkesat e Brukselit.

# Maqedonci, i ngazëllyer me punën në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-së

Prishtinë, 17 gusht (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, u është drejtuar me një letër zyrtarëve civilë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe ushtarakëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Ai është shprehur i entuziazmuar për fillimin e udhëheqjes së këtij institucioni, teksa ka thënë se së bashku do të kontribuojnë në zhvillimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, duke siguruar kështu sovranitetin dhe mbrojtjen e integritetit territorial të Republikës së Kosovës. "Jam i ngazëllyer dhe i entuziazmuar ta filloj udhëheqjen e këtij institucioni profesional të civilëve, ushtarëve dhe oficerëve, për të punuar së bashku për zgjidhjen e problemeve dhe përmbushjen e objektivave. Së bashku do të kontribuojmë në zhvillimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, duke siguruar kështu sovranitetin dhe mbrojtjen e



integritetit territorial të Republikës së Kosovës", është thënë në letrën e ministrit

Maqedonci. Në këtë letër Maqedonci ka thënë se do ta vazhdojnë

bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për realizimin e objektivave. "Kemi arritur në


këtë pikë përmes punës sonë të pandërprerë e të palodhshme, gjithashtu edhe bashkëpunimit me NATO-n, me shtetet aleate, në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Partnerë këta kyçë me të cilët do të vazhdojmë të punojmë me synim rritjen e bashkëpunimit dhe realizimin e objektivave tona të përbashkëta. Ne do të vazhdojmë t'i zhvillojmë kapacitetet e Ministrisë së Mbrojtjes për të siguruar udhëzime strategjike efektive dhe mbikëqyrje demokratike të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Do ta vazhdojmë transformimin e FSK-së në forcë me kapacitete të plota ushtarake, të gatshme për ta përmbushur misionin e saj vital në tri pika kyçe: mbrojtjen territoriale, pjesëmarrjen në misione ndërkombëtare dhe sigurimin e mbështetjes për agjencitë dhe autoritetet civile", është thënë në letrën e ministrit Maqedonci.

## ShBA-ja dhe EULEX-i, të shqetësuar për dorëheqjet e policëve serbë

PRISHTINË, 17 GUSHT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) kanë shprehur shqetësimin e tyre pasi kanë bërë me dije se tre pjesëtarë serbë të Policisë së Kosovës kanë dhënë dorëheqje. Sipas shefit të misionit të EULEX-it në Kosovë, Giovanni Pietro Barbano, policët që kanë dhënë dorëheqje i ishin bashkuar së voni Policisë së Kosovës. "EULEX- po përcjell nga afër këto zhvillime shqetësuese. Përbërja e policisë duhet të reflektojë dhe përfaqësojë shoqërinë për të cilën ata shërbejnë dhe mbrojnë. Pjesëtarët e

komuniteteve joshumicë të Policisë së Kosovës mund të kontribuojnë për sigurinë e komuniteteve të tyre përmes patrullimit", ka shkruar ai në "X". Shqetësime të ngjashme ka shprehur edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier. "Ne ritheksojmë përkushtimin tonë për një forcë policore shumetnike të Kosovës. E kam thënë disa herë, Policia e Kosovës ekziston për t'iu shërbyer të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe që zyrtarët policorë të jenë në gjendje ta kryejnë punën e tyre të lirë dhe pa frikësim. Po ndjekim nga afër këto zhvillime", ka shkruar Hovenieri në "X".

Në nëntor të vitit të kaluar pjesëtarët serbë të policisë në veri të Kosovës kishin dhënë dorëheqje si pjesë e dorëheqjeve kolektive të zyrtarëve serbë në komunat veriore - Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe Mitrovicë të Veriut - në shenjë pakënaqësie me një vendim të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe në ato RKS - Republika e Kosovës. Për ta përmbushur vakuumin e krijuar pas dorëheqjeve, autoritetet në Kosovë shpallën konkurs për pranimin e policëve të rinj. Në korrik të këtij viti 74 policë të rinj nga komunitetet joshumicë kishin filluar punën në Policinë e Kosovës.



## Bajraktari përzgjedhet për ta ndjekur Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sandhurst

PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Ushtarja e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Lirjona Bajraktari, është përzgjedhur për t'i ndjekur studimet në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sandhurst të Britanisë së Madhe, ka njoftuar ambasadori i Britanisë së Madhe

në Kosovë, Nicholas Abbott. "Është e mrekullueshme të shohësh më të ndriturit dhe më të përkushtuarit e FSK-së duke marrë pjesë në një nga institucionet ushtarake kryesore në botë në Britaninë e Madhe", ka shkruar ambasadori Abbott në "Facebook".



## Vazhdon rregullimi dhe asfaltimi i rrugicave në Prizren

PRIZREN, 17 GUSHT - Në kuadër të realizimit të projekteve kapitale, përkatësisht rregullimit të infrastrukturës së

përgjithshme në komunën e Prizrenit, në veçanti infrastrukturës rrugore, po vazhdon rregullimi dhe asfaltimi i rrugicave në

lagjen "Ortakoll", në mënyrë që të lehtësohet lëvizja dhe mënyra e jetës së banorëve. Ka filluar rregullimi i terrenit në afërsi të rrugës

"Eqrem Çabej", për asfaltimin e rrugicës që do të shërbejë për qarkullim të shpejtë në secilin drejtim të qytetit.



## Latifi: Prodhimet e 'Bodrumit të vjetër' kanë gjetur shtrirje kudo në tregun vendor dhe ndërkombëtar

Rahovec, 17 gusht - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka vizituar njërin nga kantinat prodhuese më të mëdha të verërave dhe të rakisë në Rahovec "Bodrumi i vjetër". "Miku im, Ruzhdi Haxhijaha, me djemtë e tij Fidanin, Adnanin dhe Arditin, po e ruan me fanatizëm traditën e të parëve tanë në kultivimin dhe përpunimin e prodhimeve të rrushit. Edhe pse me kushte të vështira klimatike, që këtë vit po përballen fermerët tanë në ruajtjen e prodhimit të rrushit, kjo kompani gjigante jo vetëm që vazhdon ta ruajë stabilitetin, por ka plane të mira dhe ambicioze për të avancuar në përpunimin e rrushit. Bodrumi i Vjetër ka shënuar arritje të

vazhdueshme me prodhimet cilësore dhe kulminante, të cilat na bëjnë krenarë si komunë dhe si shtet", ka thënë Latifi.

Ai ka theksuar se prodhimet e "Bodrumit të vjetër" kanë gjetur shtrirje kudo në tregun vendor dhe ndërkombëtar. "Ndërkohë, befasi e mirë ishte se si djali i bacës Ruzhdi, Adnan Haxhijaha, tash e pesë vjet po e menaxhon me shumë sukses firmën ndërtimore 'Pixel Platform' në qendër të Lubjanës në Slloveni. Z. Ruzhdi Haxhijaha dhe familjes së tij i shpreha urimet e mia më të mira, për suksese të reja, për mbarësi dhe për punën e mirë që ata po bëjnë!", ka bërë me dije Latifi.



## Ramosaj: 48 herë i shkrova Hekuran Muratit, mbi 40 herë e thirra në telefon dhe nuk përgjigjet

Deçan, 17 gusht - Kryetari i Deçanit, Bashim Ramosaj, ka denoncuar komunikimin e keq me qeverinë Kurti dhe ministrat e tij. Në një intervistë për kosoalive.net, Ramosaj thotë se kjo qeveri po e penalizon jo atë, por qytetarët e Deçanit, duke mos e ndjekur dinamizmin e punimeve në të gjithë sektorët. "Për mua është

tepër i rëndësishëm komunikimi. Është tepër e zorshme me këta njerëz. Kam një rast kur i kam dërguar letër 48 herë ministrit të Financave, Hekuran Murati. E kam thirrur në telefon mbi 40 herë dhe nuk është përgjigjur. Këta janë njerëz inatçorë dhe të mllefosur. Nuk e di pse hezitohet me pas komunikim. Ministrat të Financave

i kërkova ta shtyjë përpara aprovimin e dy kredive të buta, të iniciuara nga qeveritë e kaluara, dhe sot këto kredi nuk janë më. Nga këto kredi do të kishin një sistem krejt tjetër të shërbimit të zjarrfikësve", ka thënë Ramosaj. Ai ka theksuar se nuk e sheh veten personalisht të penalizuar nga kjo qasje e qeverisë, por komunën.

## Komuna e Drenasit fillon dëgjimet buxhetore për planifikimin e buxhetit për vitin 2024

DRENAS, 17 GUSHT - Komuna e Drenasit ka filluar mbajtjen e dëgjimeve buxhetore me qytetarë, për të diskutuar për buxhetin e komunës për vitin 2024. Deri më tani janë mbajtur dy dëgjime buxhetore me publikun. Në dëgjimet e para kanë marrë pjesë kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, kryesuesi i kuvendit të komunës, Milaim Hajdari, nënkryetari Arben Shala, drejtorë të drejtorive komunale, gra, të rinj, studentë e shumë qytetarë.

Të pranishmit i ka përshëndetur edhe kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, i cili i ka falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje dhe ka vlerësuar se me pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe grupeve të interesit, buxheti i komunës do të jetë gjithëpërfshirës për të mirën e përgjithshme të qytetarëve të Drenasit. Ndërsa të pranishmit kanë paraqitur kërkesat dhe nevojat e tyre për të cilat kanë kërkuar të jenë pjesë e projekcionit të buxhetit për vitin 2024-2026.



## Rama: Lokalet e gastronomisë që nuk respektojnë decibelët e lejuar do të gjobiten

Prishtinë, 17 gusht - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka vizituar të enjten

Dhomën e Monitorimit të Ndotjes Akustike në Inspektoratin e kryeqytetit. Ai ka bërë me dije se nga e

hëna fillojnë zyrtarisht punën dhe duke u bazuar në rregulloren e miratuar në Kuvend, që të gjitha

lokalet e gastronomisë në kryeqytet, të cilat nuk respektojnë decibelët e lejuar, do të gjobiten.





# Albin Kurti, adhurues “i flaktë” i Arif Ziberit dhe grupit “Elita 5”



Shkruan: Behxhet  
Sh. SHALA - BAJGORA

**Protesta për “solidarizim”:** Një antipod i Adem Jasharit, komandantit legjendar të Shqiptarisë, organizoi një protestë solidarizimi në Prishtinë në përkrahje të Albin Kurtit, kryeministër dhe Vojsa Osmanit, presidente. Mund të jetë edhe rastësi, por ky “komandant” politik ishte nga Skenderaj, komuna nga ishte edhe komandanti legjendar i cili, në këto protesta, shpalosi edhe disa pankarta që gjuhësisht më mirë do të shkruheshin në Nish dhe Kragujevc se që janë shkruar në Kosovë. Nuk kishte fjalë pa gabime të cilat do t'i vërenin edhe nxënësit e klasës së parë që mësojnë sipas Abetares së Unifikuar, e arritura më e madhe e shqiptarëve në këtë shekull. Ishin interesante, sidomos për psikologët dhe psikiatrit kërkesat e shtruar në këtë protestë “gjithëpopullore” në përkrahje të pushtetit e që i ishin drejtuar opozitës; opozita të jetë më konstruktive dhe mos ta pengojë pozitën në Kuvend, kurse për analistët që i cilësuan se janë me Serbinë, duhet të organizohen gjykime publike dhe të dënohen varësisht se sa i kanë “shërbyer Serbisë”. Më herët kur Kuvendi mbulohej me gaz lotsjellës, kur “armët e ftohta” futeshin në Kuvend përmes “rrugëve anatomike”, kur Isa Mustafa sulmohej me mjete shumë rrezikuese, deri kur edhe e granatuan ndërtesën e Kuvendit, opozita konsiderohej si konstruktive, kurse pozita në asnjë rast nuk organizoi “protesta për solidarizim” me udhëheqësit e atëhershëm. Sidomos nuk kishte asnjë kërkesë që analistëve t'u organizohet një gjyq publik ndonëse në të shumtën e rasteve ishin të pamëshirshëm ndaj opozitës duke e ndihmuar Albin Kurtin dhe LV-në të arrijë mbi 50 % të votave. Tash po e marrin “shpërblimin e merituar”. Më mirë vonë se kurrë! Tash, pas ultimatumit të këtij “komandanti” politik në mbrojtje të figurës dhe veprës së Albin Kurtit dhe Vojsa Osmanit, opozita i detyrohet pozitës një falje publike me zotim se Vox Pozita është Vox Dei (zëri i pozitës është zëri i Zotit) dhe se këtu përfundon veprimi opozitar. Çfarë injorantësh që dalin me këto kërkesa për opozitën! Ndërkaq, sa i përket gjyqimit publik të analistëve që po cilësohen si bashkëpunëtorë të Serbisë, po mundohem ta parashikoj rrjedhën e

zhvillimeve duke u kthyer në kohën e inkuizicionit kur gjykatat shquheshin për humanizëm dhe renesanë duke përdorur, në vend të Kodit Penal, kryqëzimin dhe stivën e druve. Po e shoh Kimete Berishën të torturuar gjatë procesit të ekzorizimit (përzënies së djallit nga trupi), para se ta vendosin në stivën e druve për t'i vënë flakën. Sikur në kohën e Inkuizicionit kur hetues ishin ata që moralizonin para se të futeshin në mëkate. Tash këta priftërinjtë politikë të LV-së janë edhe më të pamëshirshëm në luftimin e armiqve politikë. Po cili prej analistëve do të duhej të gozdohej si dikur Krishti, nëse nuk ka qenë vetëm një përrallë e sajuar. Ilir Mirena nuk bën sepse është i besimit islam dhe nuk ka flokë. Po t'i vendosin një paruke, do ta humbte originalitetin. Milaim Zeka është i papërshtatshëm për faktin se e ka një fjalor të papërshtatshëm me normat morale të asaj kohe. Sigurisht se do ta shante Pont Pilatin me nënë e robë shtëpie. Halil Matoshin me dëshirë do ta gozhdonin, por edhe ky nuk i plotëson do kushte, përveç mosdurimit që e kanë ndaj tij. Berat Buzhala është katolik, ka flokë dhe mirë do të dukej i gozhdur në kryq duke rrugëtuar nëpër Via Dolorosa. Aktualisht është personi më i përshtatshëm për t'u gozhdur dhe jam i sigurt se do të kishte shumë vullnetarë nga LV-ja dhe diaspora që do t'i ngulnin edhe më shumë gozhdën se që është e nevojshme. Kjo protestë e organizuar në përkrahje të Albin Kurtit dhe Vojsa Osmanit është kulmi i marrëzisë, është Himalaja e injorancës dhe Mont Everesti i servilitetit. Turp!

**The Final Countdown dhe Elita 5:** E pranoj publikisht se kontributi im në ngritjen e figurës politike dhe veprës së shokut Albin Kurti ishte bukur i madh, në të gjitha aspektet e mundshme sepse kam besuar se Albini është Vox Populi (Zëri i Popullit) sikur edhe personi më i kualifikuar për të jetësuar kërkesat e Vox Populi. Bashkë me Bacën Adem e përkrahëm deri në çastin kur Baca Adem tha: “mjafte më, nuk e ka më përkrahjen time”. Unë, si boshnjaku, edhe për një kohë e përkrahja duke besuar se edhe Baca Adem do të rikthehet. Realisht, Baca kur më nuk u rikthye dhe më habitë fakti kur Albini deklarohet se: “është djallë politik i Adem Demaçit dhe biologjik i Zaim Kurtit”. Kjo e dyta është e vërtetë, e para aspak nuk është e vërtetë. Në atë kohë lexoja, për të satën herë Princin e Makiavelit ku flitej për përdorimin e mënyrave më të paskrupullta për marrje të pushtetit dhe për mënyra super të paskrupullta për ruajtje të pushtetit. Në të njëjtën kohë lexoja edhe Udhëzimet e Të Mençurve Sionistë për marrje

dhe ruajtje të pushtetit, që ishte shkollë edhe më e sofistikuar se ajo e Makiavelit, në përkthim të Fatos Aliut. Pata menduar se kam fituar njohuri të mjaftueshme që të mos kurthohem në rrjetin e atyre që në mënyrë të pamoralshme dhe të paskrupullt e marrin pushtetin. Jam treguar se jam leshko i vërtetë.


Në njërin ndër festivalet e Filmit Dokumentar për të Drejtat e Njeriut “Një Botë”, në përppjekje ta lartësojmë personalitetin dhe veprën e shokut Albin Kurti, e ftuam të jetë mysafiri kryesor që do ta bëjë hapjen e Festivalit. E kishte vetëm një kërkesë e ajo ishte që, si kolon zanore e Festivalit të përdoret The Final Countdown, që atëherë ekzekutohej nga grupi Europe. Natyrisht se e përkraha ndonëse shumë të pranishëm nuk kishin dëgjuar për këtë këngë. Realisht, pas një kohe mendoja se këtë videoklip Albini e kishte si moto politike për rrugëtimin e tij politik ...Numërimi i Fundit (përkthimi në shqip) nënkuptonte përfundimin e një Maratone apo qëllimi për ngjitje në maja të pushtetit. Albini ka shije të stërholluar për muzikë të zhanreve rok, rege, bluz, soul dhe, pasi u bë politikan i njohur edhe të muzikës rep. Repovat më mirë se Capital T. Në një emision, ndër shumë pyetje ishte edhe për listën e grupeve dhe zhanrit të muzikës që i pëlqen. Vetëm njohësit e mirë të muzikës e kuptojnë shijen e hollë të Albinit për muzikën. Mirëpo, që më bëri shumë përshtypje, si politikan që bashkimin kombëtar e kishte si ujë, ajër dhe dritë (sa mirë tingëllojnë po të ishte e vërtetë) se në atë listë nuk kishte asnjë grup apo këngëtar shqiptar, madje as Arif Ziberi dhe Elita 5. Javën që shkoi, gjatë një vizite në kundërshtim të plotë me protokollin e shtetit dhe të drejtën ndërkombëtare, Albin Kurti bëri një vizitë në Shkup, lagjen Çair për t'u takuar me kryetarin e kësaj komune me ç'rast u përruaa Rruga “Adem Demaçi”. Para kësaj vizite, presidentja e Kosovës Vojsa Osmani bëri një vizitë zyrtare ku u takua me kryetarin e Sobranies (Kuvendit) të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi dhe, në kuadër të vizitës u inaugurua Rruga “Ibrahim Rugova”. Gjatë përrurimit të Rrugës “Adem Demaçi”, kryeministri Kurti ofroi për të pranishmit një pjatë të mbushur dhe të stërmmbushur me fasule patriotike, nga e cila, pastaj shumë të pranishëm kishin problem me tretjen. Çështja e këtij emërtimi u bë problem kombëtar në Maqedoni të Veriut dhe tani, me kërkesën e kryetares së Shkupit ka filluar nisma për anulimin e emërtimit të Rrugës me emrin e Adem Demaçit. Për emërtimin e Rrugës me emrin “Ibrahim Rugova” nuk kishte asnjë reagim zyrtar. Pse

Adem Demaçi duhet të keqpërdoret edhe për së vdekuri për qëllime të ulëta politike?! Pse Adem Demaçi, edhe për së vdekuri duhet të përdoret si mjet për promovimin e Izetit dhe Bilall Kasamit për rrëzim të Ali Ahmetit, nën dirigjimin e Albin Kurtit?! Njeriu normal e ka vështirë ta kuptojë këtë, për të krisurit kjo është gjendje normale. Po, pikërisht në këtë mbrëmje e kuptuam se sa shumë e vlerëson Albin Kurti Arif Ziberin dhe grupin Elita 5. Grupi Elita 5 ka merita të mëdha për afirmim të muzikës dhe rokut shqiptar, që nga koha e ish-Jugosllavisë e deri më sot. Kanë krijuar dhe e ruajnë një strukturë të qëndrueshme të dëgjuesve të të gjitha moshave. Unë i kam dëgjuar sikur edhe të tjerët por jo se vdesë për ta. Më duket varianti shqip i një rok grupi nga Pula e Kroacisë i quajtur (Atomsko Sklonishte). Vitin e kaluar qëllova në Pogradec dhe isha në koncertin e Elita 5. Arifi ishte lodhur pak. Bilall Kasami e shfrytëzoi koncertin e Elita 5 për promovim të vetes në luftë kundër Ali Ahmetit, i ndihmuar dhe përkrahur nga Zubin Mehta i politikës kosovare, Albin Kurti. Edhe nga Izeti sikur edhe nga pluhuri i mbetur politik pas djegies së Zijadin Selës. Blerim Reka ishte i zënë në një syneti në Nju Jork ku është edhe konsull i Kosovës, si shpërblim i Albinit për disa çështje të natyrës private, thellësisht emocionale dhe romantike!

Në Maqedoni të Veriut Bilall Kasami identifikoihej si djallë politik i Rexhep Taip Erdoganit. Çfarë coincidence, edhe djali biologjik i Erdoganit e ka emrin Bilall. Dy në një emër! Në keqpërdorimin e përrurimit të Rrugës me emrin “Adem Demaçi” dhe në keqpërdorimin e koncertit të Elita 5 u promovua një grup i unifikuar për ta luftuar BDI-në dhe, në veçanti Ali Ahmetin. Madje, në këto keqpërdorime masive të gjitha shpresat për rrëzim të Ali Ahmetit u mbështetën te Albin Kurti të cilin e quajtën “kryeministër të gjithë shqiptarëve” në kohën kur është vetëm kryeministër i kosovarëve, Nenad Rashiçit dhe Rada Trajkoviçit, tash edhe kontabilistit të luftës, paqësorit të ushtrisë kriminale të Serbisë, Radoica Radomiroviç që, sipas disa deputetëve të LV-së që nuk e kanë dhënë asnjë kontribut për luftën, çlirimin dhe lirinë, qoftë shkaku i moshës, qoftë se kanë qenë pjesë e kotillës politike dhe kombëtare jugosllave dhe serbe, ky farë Radomiroviç nuk ka marrë pjesë në luftën në Kosovë. As Slobodan Millosheviç nuk ka marrë pjesë në luftën në Kosovë, madje as që ka qenë i uniformuar, madje as si kontabilist, o ju të poshtër dhe pa asnjë ndjenë kombëtare dhe njerëzore. Vetëm për respekt të viktimizeve, të të zhdukurve dhe

femrave të dhunuara, një pjesëtar i uniformuar i ushtrisë serbe gjatë luftës në Kosovë nuk do të duhej të emërohej z/ministër qoftë edhe me yll në ballë qoftë, o të poshtër! Nenad Rashiç ka interes ta mbrojë Radomiroviçin, po cili është interesi i juaj, o të poshtër! Interesin e shqiptarëve në Maqedoni të Veriut aktualisht nuk e përfaqëson dhe mbron askush më mirë se Ali Ahmeti. Këtë interes nuk mund ta mbrojnë ata që kanë dalë nga grazhdi i Ali Ahmetit e që tash duan ta kenë grazhdin personal, që të marrin sa të duan vet e jo sa t'u vendosë dikush tjetër në të. Shqiptarët në Maqedoni të Veriut asnjëherë nuk kanë qenë më të përfaqësuar në institucione se që janë tani, asnjëherë nuk kanë qenë më mirë. Janë përcaktues në vendimmarrje. Pra qëllimi i kësaj vizite jonormale të Albin Kurtit në Maqedoni të Veriut nuk është respektimi i emrit dhe veprës së Adem Demaçit (në Kosovë nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim) e as përmirësimi i gjendjes së shqiptarëve atje por ndërtimi i një fronti të përbashkët kundër Ali Ahmetit, hakmarrje për djegien e Zijadin Selës duke e përdorur të birin politik të Erdoganit, Bilall Kasamin. Edhe ky do të digjet por nuk e besoj se Albini do të derdhë lot mbi hirin e tij politik. Albini po krijon kriza politike për të mbijetuar politikisht. Për këtë nuk ka pasur fare nevojë me mbi 50% të votave. Albini ka probleme të mëdha, fillimisht me Albinin pastaj edhe me të tjerët. E pretë: “një vjeshtë, me stuhi...”. Nuk ka më hapësirë të madhe manovruese, do të luftojë për frymëmarrje, sa për të mbijetuar. Është prodhues shumëfish më i madh i krizave se që ishte Hashimi sikur që është edhe improvizues i papërsëritshëm i rrethuar me puthadorë, injorantë, lakej, spiunë të UDB-së, projugosllavë dhe proserbë. Patriotët e vjetër janë të heshtur, i rrinë cuc andartes greke, Babushkës ideologjike të LV-së duke recituar vjershën Zdravo Limoza. Albini duhet t'i kthehet rrënjëve, prej gjetheve jo që nuk jetohej, por as nuk mbijetohej. Nuk e ka armik as Edi Ramën e as Ali Ahmetin, duhet të bashkëpunojë me ta, ta marrë përvojën e tyre prej burrështetasi e që Albini nuk e ka. Duhet ta filtrojë qeverinë prej injorantëve, abuzuesve, antikombëtarëve, dashakeqëve sikur edhe duhet t'u thotë lamtumirë dhe mirë mos u pafshim anarkistëve të Tiranës. Albin Kurti ka kapacitet intelektual dhe politik t'i përballojë sfidat, por jo me këtë qasje, jo me këta njerëz, jo me urrejtje, jo me përjashtim dhe jo me demagogji. A do ta gjejë rrugën e humbur, shumë shpejtë do ta shohim. Uroj që ta gjejë në të kundërtën theqafjen e ka të garantuar! Qofsha i gabuar!

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# Ballkani kualifikohet në 'play-off' të Ligës së Konferencës

PRISHTINË, 17 GUSHT - Kampioni i Kosovës, FC Ballkani e ka kaluar me sukses edhe rrethin e tretë në Ligën e Konferencës, pasi ka shënuar fitore edhe në ndeshjen e kthimit ndaj skuadrës nga Gjibraltari, Lincoln Red Imps. Pas fitores 2:0 në stadiumin "Fadil Vokrri" një javë më parë, skuadra e Ilir Dajës konfirmoi kalimin në fazën e "play-off"-it me fitore si mysafire me shifrat 3-1. Golat për

Ballkanin i shënuan Meriton Korenica (48'), Edvin Kuç (64') dhe Qëndrim Zyba (90'+), derisa golin e vetëm për vendasit e realizoi Juampe Rico (66'). Në "play-off" kampioni i Kosovës me gjasë të mëdha do të përballet me humbësin skuadrën bjelloruse, BATE Borisov, e cila në ndeshjen e parë të rrethit të tretë në Ligën e Evropës ka humbur 5-1 nga Sheriff Tiraspol.



# Rashica: Kur bëjmë shqiponjën, të gjithë e dinë se kush jemi

Stamboll, 17 gusht - Repreruesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, nga Norwich City i është bashkuar skuadrës së madhe turke Beshiktash për 5.5 milionë euro. Ai është pritur me entuziazëm të madh nga tifozët e skuadrës, kurse ka zgjedhur numrin 11 në fanellë. Ai tashmë ka dhënë intervistën e parë për faqen zyrtare të klubit, në të cilën ka folur edhe për simbolin e shqiponjës që lojtarët shqiptarë e bëjnë me duar gjatë çdo festimi të tyre. Rashica u shpreh shumë i lumtur dhe i emocionuar për transferimin në Beshiktash. "Shqiponja është simboli ynë kombëtar, simbol për popullin e Shqipërisë dhe Kosovës. Kur bëjmë shenjën e shqiponjës, ata që na shohin e dinë kush jemi. Kjo vlen edhe për ata që shohin flamurin tonë. I festova golat e mi duke bërë shenjën shqiponje. Ka një kuptim shumë të veçantë për të gjithë ne", ka thënë Rashica. Ish-anëtari i Vitesse, Werder Bremenit dhe Norwich Cityt më pas ka thënë se kalimi te Beshiktashi ishte zgjedhja më e mirë. "Që në momentin e parë që nisëm negociatat me Beshiktashin, ata më respektuan dhe më bënë të



ndieja se më donin shumë. Kjo ishte gjëja më e rëndësishme për mua dhe doja të kthehesha në Turqi, ku isha i lumtur. Mua dhe familjes sime më pëlqeu shumë ky vend dhe kaluam një kohë të mirë këtu. Shumë të mira kanë qenë edhe planet dhe projektet që më ka paraqitur klubi. Më bënë të ndihem sikur më donin, prandaj zgjedha këtë vend. Kam luajtur në këtë stadium vitin e kaluar. Atmosfera ishte shumë e mirë. Mund të them se tifozët në Turqi janë në një nivel krejt tjetër", ka shtuar Rashica.

Ai foli edhe për objektivat e tij me klubin e ri. "Shpresoj se mund të shënoj shumë gola dhe asistime, por nuk ka shumë rëndësi se në çfarë pozicioni luaj, sinqerisht. Përpiqem ta jap kontributin më të mirë për ekipin tim. Nuk janë vetëm gola dhe asistime. Është gjithçka që mund të bëj kur jam në fushë. Më parë kam veshur numrin 11. Është një numër që më pëlqen. Ata thanë se mund ta marr këtë numër. Edhe unë jam i lumtur për këtë. Shpresoj të kemi një sezon të mirë", ka deklaruar Rashica.

# Besa Famgas e nis mbrojtjen e titullit ndaj Vushtrrisë, Istogu kundër Prishtinës

Pejë, 17 gusht - Besa Famgas do ta fillojë në Vushtrri mbrojtjen e titullit të kampionit në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Kështu është përcaktuar me shortin e tërhequr në lokalet e Federatës së Hendbollit të Kosovës. Superliga e hendbollistëve do të përbëhet nga tetë skuadra. Do të luhet sistem i katërfishtë e më pas është plejofi. Ndeshjet e xhiros së parë zhvillohen më 16 e 17 shtator. Pos ndeshjes Vushtrria - Besa Famgas, në xhiron e parë janë edhe ndeshjet Prishtina - Rahoveci, Kastrioti - Trepça e Deçani - Vëllaznimi. Derbi pritet të jetë ndeshja në mes të Prishtinës e Rahovecit. Edicioni 2023/2024 i Superligës së Kosovës në hendboll

(femrat) nis me ndeshje interesante. Shorti për kampionatin e ri është tërhequr të mërkurën në lokalet e Federatës së Hendbollit të Kosovës. Tërheqjen e shortit e ka bërë komisar i garave, Isak Osmani. Kampioni aktual, Istogu, mbrojtjen e titullit e fillon në Prishtinë. Takohet me skuadrën e Prishtinës në xhiron e parë, që zhvillohet më 16 e 17 shtator. Ndeshje tjetër interesante pritet të jetë ajo në mes të Ferizajt dhe Vushtrrisë. Samadrexha - Vëllaznimi, Jusuf Gërvalla - Ulpiana, Kastrioti - Shqiponja janë ndeshjet e tjera të xhiros së parë. Në Superligën e hendbollistëve garojnë dhjetë skuadra. Pas 18 xhirove të stinorit të rregullt zhvillohet faza e plejofit.



# Në katër qytete do të zhvillohet kampi i basketbollit për të rinj

Prishtinë, 17 gusht - Nga 21 deri më 28 gusht nga Kosovo Basketball Heritage Academy dhe Federata e Basketbollit e Kosovës do të organizohet kampi për basketbollistët dhe basketbollistët e reja të

moshës prej 8-16 vjet në katër qytete të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë dhe Gjakovë. Çdo kamp do të përfshihet për fëmijët e moshës 8-16-vjeçare dhe aty do të

përfshihen deri në maksimum 30 kampistë për seancë. Dy seanca të përshtatshme do të zhvillohen në çdo qytet: Në mëngjes nga ora 9:00-12:00 për kampistët e moshës 8-12

vjeçare, pasdite nga ora 13:00-16:00 për kampistët e moshës 13-16 vjeçare. Lojtarët më të mirë nga çdo kamp përkatës i distriktit do të ftohen të marrin pjesë në një All-Star final njëditor, që



do të mbahet në Prishtinë më 25 gusht.

## Kosova, vend me potenciale për energji solare, boshllëku ligjor pengon investitorët

PRISHTINË, 17 GUSHT - Procedurat burokratike janë duke ia humbur Kosovës qindra miliona euro investime në sektorin privat të energjisë solare. Komunitat dhe Ministria e Mjedisit ia hedhin fajin njëra-tjetres për politikën mjedisore. Afrim Sylja nga kompania "Elen" ka deklaruar se pritja për të marrë një pëlqim mbi realizimin e një parku solar në rrethinë të komunës së Shtimes po vazhdon me muaj të tërë. Sylja ka deklaruar se komuna e Shtimes, pavarësisht prej masave ligjore, e ka drejtuar kompaninë "Elen" në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe anasjelltas. Sylja ka vlerësuar se kjo paraqet një mangësi të ministrisë në përfundimin e zyrtarëve komunalë për procedurat. "Fillimisht kemi shkuar në komunë, kemi hasur në

vështirësi dhe jemi ballafaquar me përgjigje që nuk i kemi dashur. Mungesa e planit zhvillimor të planit të komunës së Shtimes, e pamundëson ose e pengon procesin e investimit në energji solare. Nga Ministria e Ambientit kërkohet që komunat të cilat duan të pranojnë investime të tilla duhet ta kenë në planin e tyre zhvillimor energjinë solare", ka deklaruar ai për "TV Dukagjini". Ai ka thënë se shqetësuese është se zyrtarët e komunës janë të përfunduar me ligjet aktuale në Kosovë për çdo lloj investimi. Sylja ka treguar se investimet e kompanisë dhe bashkëpunëtorëve të saj janë në pritje, derisa ka theksuar se nga aktivitetet e tyre për të investuar në këtë zonë mbushin një vit në tetor. Ndërsa nënkryetari i komunës së Ferizajt, Lulzim Aliu, ka deklaruar se plani zhvillimor



komunal nga ana e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës po trajtohet si i pandryshueshëm, interpretim ky i cili është i gabuar. Sipas tij, brenda ministrisë në fjalë mbeten dy grupe në kundërshtim me njëra-tjetrën. "Ministria e Mjedisit ka dilema dhe gabimi më i madh është interpretimi i

Ligjit për Planifikim Hapësinor. Në ministri janë të ndara dy grupe në kuadër të institucionit që kanë mendime të ndryshme, posaçërisht për planin zhvillimor komunal. Është shumë saktë e shpjeguar që si dokument është strategjik dhe çfarëdo që futet në këtë strategji nuk është e saktë, nuk është me kufij. Ministria e

Mjedisit ka qenë kategorike në një interpretim që është më i gabueshmi dhe e ka marrë në qafë gjithë Kosovën, jo vetëm fushën e energjisë, por edhe të ndërtimeve", ka thënë Aliu. Ai ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta trajtojë në mënyrë serioze problemin e energjisë. Ndërsa Visar Prebreza nga "BIRN-i" ka thënë se planet apo vizionet për energji janë shumë të rëndësishme për shtetin. Ai ka thënë se Plani Zhvillimor Komunal hartohet nga komunat, disa nga të cilat, sipas tij, nuk kanë kapacitete njerëzore për një strategji të energjisë solare në Kosovë. Prebreza ka thënë se nëse Qeveria e Kosovës e krijon një strategji të energjisë, ajo strategji duhet të ndiqet edhe nga ministrinë e tjera dhe komunat.

## Sa fitojnë kompanitë e derivateve të naftës?

PRISHTINË, 17 GUSHT - Në shumicën e pikave të shitjes të karburanteve në Kosovë, çmimi për një litër naftë sillet nga 1.44 euro deri në 1.50 euro. Çmimet ndryshojnë varësisht nga pikat e shitjes, lokacioni apo qyteti. Në një pikë të shitjes së derivateve në komunën e Shtimes një litër naftë shitej për 1.34 euro. Për të gjitha kompanitë, marzha e fitimit me pakicë është 12 centë në litër, kurse me shumicë 2 centë. Përcaktimi i fitimit është bërë në bazë të një vendimi të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) të datës 28 korrik. Vendimi do të jetë në fuqi për një muaj, por jo të gjitha kompanitë po e respektojnë këtë vendim të MINT-it. Për këtë çështje ndaj katër kompanive që shesin produkte të naftës, MINT-i dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) kanë iniciuar procedurë gjyqësore. Autoritetet nuk kanë treguar se për cilat kompani bëhet fjalë, porse për gjohjen ndaj tyre do të vendosë gjykata. "Vendimi po e mban nën kontroll çmimin e naftës. Përndryshe, gjatë këtij muaji do të kishte çmime



shumë më të larta të këtij produkti në treg", kanë thënë zyrtarët e MINT-it për "Radion Evropa e Lirë". Nga Shoqata e Naftëtarëve e Kosovës kërkohet që qeveria të mos i vazhdojë masat mbrojtëse, duke argumentuar se ato vështirësojnë operimin e kompanive të këtij sektori. Kreu i kësaj shoqate, Fadil Berjani, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se tavani i lejuar i fitimit prej 12-centësh për litër është i pamjaftueshëm pasi, sipas tij, po pamundëson rritjen e pagave për punëtorët dhe mbulimin e shpenzimeve të nevojshme të operatorëve. Ai ka propozuar që marzha të jetë 16

centë. "Çmimi i derivateve të naftës nuk varet nga tregtarët, por nga bursa ndërkombëtare. Ne kemi çmimet më të lira në rajon, përveç Maqedonisë së Veriut, e cila e ka akcizën më të lirë për 20 centë. Ne dëshirojmë të kemi çmime më të lira, por çmimi i derivateve të naftës nuk varet nga tregtarët, por nga bursa ndërkombëtare", ka thënë ai.

Nafta e papërpunuar Brent, e cila përdoret si pikë ndërkombëtare e referimit, më 15 gusht, ka rënë në rreth 85 dollarë për fuçi. Por, në kompaninë "EuroKos Petrol" që gjendet në komunën e Shtimes, çmimi për një litër

naftë (më 15 gusht) kushtonte 1.35 centë, kurse benzina 1.37 centë. Diellon Kelmendi, menaxher në këtë kompani, ka thënë se me këtë çmim fiton deri në 12 centë. Kjo shumë, ka thënë ai, është e mjaftueshme për t'i mbuluar shpenzimet e nevojshme në kompaninë e tij. "Kemi pak telashe nga konkurrenca. Po na bëjnë presion pse po i mbajmë çmimet e lira. Asnjëherë nuk e kalojmë marzhën e fitimit prej 12-centësh. Ne punojmë me fitim edhe 4-5 centë", ka thënë ai.

Pas hyrjes në fuqi të vendimit të qeverisë, Autoriteti i Konkurrencës, nga 31 korriku deri më 3 gusht, ka monitoruar 60 pika të shitjes së karburanteve në gjashtë rajone të Kosovës. Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", nga ky autoritet kanë thënë se gjatë inspektimeve janë vërejtur çmime të ndryshme varësisht nga kompanitë. Kompanitë të cilat kanë ndikim të ndjeshëm në treg kanë çmime më të larta e që, sipas deklaratimit të tyre, lejon zbritje nga 3 centë deri në 5 centë për litër, kurse kompanitë e vogla nuk kanë çmime zbritëse,

çmimet e tyre janë fikse, dhe i kanë çmimet më të ulëta sesa kompanitë të cilat kanë ndikim më të madh në treg, sepse marzha e tyre e fitimit sillet nga 7 deri 10 centë për litër. Pavarësisht prej çmimeve të ndryshme, zyrtarët të Autoritetit të Konkurrencës pohojnë se nuk kanë ndonjë arsye për hetime momentale. Kosova është e varur nga importi i karburanteve të naftës. Çmimi vendosën varësisht nga furnizimet në rajon apo në Evropë. Përveç çmimit të blerjes, në Doganën e Kosovës kompanitë importuese paguajnë akcizë në vlerë 0.35 euro për një litër naftë, pastaj këtu shtohet Tatimi Mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) prej 18-përqindësh, transporti dhe shpenzimet e tjera. Qeveria e Kosovës edhe në muajin mars të vitit të kaluar kishte vendosur tavan të çmimeve për shitjet me pakicë dhe shumicë të derivateve të naftës. Atëbotë në Kosovë një litër naftë ishte shitur për 1.68 euro, ndërkaj çmimi i benzinës ishte 1.67 euro dhe çmimi i naftës së papërpunuar Brent kishte arritur nën 130 dollarë për fuçi.

## Murati: Mbi 740 milionë euro buxhet për komunat për vitin 2024

PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka bërë me dije se kanë dorëzuar qarkoren e dytë për buxhetin komunal për vitin 2024, sipas së cilës, buxheti i komunave do të rritet në 742.3 milionë euro ose 90 milionë euro më shumë se në vitin 2023. "Dje kemi dorëzuar qarkoren e dytë

për buxhetin komunal për vitin 2024, e cila parasheh që buxheti i komunave të rritet në 742.3 milionë euro. Po bëhet tashmë viti i dytë radhazi që rritja e buxhetit është në përqindje dyshifrore krahasuar me vitin paraprak. Në vlerë absolute, buxheti i vitit 2024 rritet për gati 90 milionë euro krahasuar me vitin 2023", ka shkruar

Murati në "Facebook". Ai ka thënë se që nga fillimi i mandatit, për tri vjet, buxheti vjetor i komunave është rritur për 195 milionë euro më shumë. "Suksesi i qeverisë në menaxhimin më të mirë të financave publike dhe në mbledhjen e të hyrave përketet në buxhet më të lartë për komunat", ka shkruar Murati.



# Analiza e Financial Times: Shqipëria është “Little Italy”. Turistët dynden në rezortet low cost



Kryeministrja italiane Giorgia Meloni bëri një vizitë të papritur në Shqipëri këtë javë, duke iu bashkuar mijëra pushuesve që kanë zgjedhur vendin ballkanik për shkak të çmimeve në rritje të Italisë dhe motit ekstrem.

Meloni zgjodhi një rrugë me kosto të ulët, duke marrë një traget nga rajoni jugor italian i Pulias, ku ndodhej me pushime me familjen e saj, për në portin shqiptar të Vlorës.

Një nga vendet më të varfra të Evropës, Shqipëria ka luftuar për dekada për të hequr reputacionin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, që ka shtyrë qindra mijëra shqiptarë të emigrojnë. Por tani po gëzon një ringjallje ekonomike pjesërisht për shkak të një bume turistike.

Të tërhequr nga plazhet e saj mesdhetare me çmime konkurruese, pasagjerët e linjave ajrore në Shqipëri u dyfishuan në qershor, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, sipas ACI Europe, një shoqatë e operatorëve të aeroportëve. Hapja e linjave me kosto të ulët për në aeroportet shqiptare kontribuoi në këtë rritje, sipas ACI.

Shifrat e fundit të Eurostat-it tregojnë 261,000 netë të kaluara nga turistët të huaj në Shqipëri në tremujorin e parë, 152 për qind më shumë se sa e njëjta periudhë e 2019-ës.

Ndërsa turistët e huaj vazhdojnë të dynden drejt Italisë – me të ardhurit ndërkombëtarë 43 për qind më shumë në katër muajt e parë krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2022 – udhëtimet e brendshme ranë 20-30 për qind në krahasim me vitin e kaluar në rajone të caktuara, sipas Federturismo.

Marina Lalli, kryetare e

Federturismo, tha se rënia e turistëve vendas “duhet të shërbejë si një kampion alarmi – ky vit nuk do të jetë një vit totalisht i rezervuar”.

Ministria italiane e financave tha se ishte duke u mbështetur tek turistët për të rritur produktin e brendshëm bruto të vendit në tremujorin e tretë pas të dhënave zhgënjyese të tremujorit të dytë, kur prodhimi u turr 0.3 për qind, krahasuar me tre muajt e mëparshëm.

Përveç çmimeve të fryra, valët e të nxehtit, zjarret në jug dhe stuhitë veriore kanë çuar të gjitha në anulime të minutës së fundit këtë verë. Në Sicili, një zjarr dhe një shpërthim vullkanik mbylli aeroportin e Katania, duke çuar në mijëra anulime dhe akuzë për reagimin e ngadaltë të autoriteteve.

Në një video virale, influencuesi indian i udhëtimeve Aakanksha Monga u bëri thirrje turistëve të “mos shkojnë në Itali” gjatë verës, duke argumentuar se vapa dhe turmat ishin të padurueshme ndërsa çmimet ishin më të larta “se në Norvegji”.

Mediat tradicionale në Itali e kanë cilësuar gjithashtu Shqipërinë si destinacionin “në modë”, duke laldëruar plazhet e saj me rërë fildishi si Karaibet e Evropës.

Melonit iu bashkua në udhëtimin e saj të profilit të ulët edhe partneri dhe vajza e tyre gjashtëvjeçare. Ata takuan homologun e saj shqiptar, Edi Rama, dhe familjen e tij të hënën dhe të martën, sipas një personi që ka dijeni.

Një zyrtar italian tha se Meloni mori pjesë në një darkë të organizuar nga Rama të martën. Megjithatë, disa media vendase dhe një tjetër zyrtar italian thanë se ajo u kthye në Itali të martën

për të festuar “Ferragoston”, një festë kombëtare. Zëdhënësit e kryeministres nuk iu përgjigjën kërkesave për koment.

Rama në fillim të kësaj jave e përshkroi Melonin si një “tugër”. I njohur për stilin e tij konfrontues, kryeministri shqiptar u mburr në rrjetet sociale me foto që tregonin tragete plot me turistë italianë, duke i etiketuar me ironi si një “pushtim” – një term i ngarkuar pasi lideri fashist Benito Mussolini pushtoi Shqipërinë në vitin 1939 deri në 1943, kur nazistët pushtuan vendin.

Ai tha se turistët italianë në vendin e tij arritën pothuajse “gjysmë milion” këtë vit. Mediat italiane e vlerësojnë shifrën në më shumë se 300,000, 57 për qind më shumë krahasuar me të gjithë vitin 2022.

Ndërsa çmimet janë rritur në Itali, turistët ndërkombëtarë janë joshur nga kostot më të ulëta shqiptare për çdo gjë, nga akomodimi në hotel deri te restorantet dhe shezlongët. Agjencia Federale e Statistikave të Gjermanisë zbuloi së fundmi se çmimet e restoranteve dhe hoteleve në Shqipëri ishin 56 për qind më të ulëta se ato të Gjermanisë – duke e bërë atë destinacionin më të lirë të pushimeve në Evropë.

Midis vizitorëve ishte Nicolas Ferrero, një prodhues 28-vjeçar protezash nga qyteti i Riminit në Italinë veriore. Ai e përshkroi udhëtimin me traget si “kaotik” me shumë britanikë, italianë dhe shqiptarë në bord. Kur mbërriti në resortin e Sarandës pranë kufirit grek, plazhi ishte i mbushur plot me italianë. “Ishte Little Italy,” tha ai.

Ferrero tha se prej kohësh kishte dashur të vizitonte vendin e shqiptarëve, pasi u rrit në një

komunitet që përfshinte disa emigrantë shqiptarë. Meqenëse ai “tashmë kishte parë pjesën më të madhe të Italisë”, kjo ishte një kulturë dhe kuzhinë e re për t’u eksploruar. Një bonus është se shumë shqiptarë flasin italisht. Disa blogerë italianë udhëtues kanë promovuar gjithashtu pushimet në Shqipëri, duke i quajtur vetëm një “shëtitje me traget të lirë” larg.

Një udhëtim vajtje-ardhje nga Bari në Durrës kushton rreth 100 €. Udhëtimet vajtje-ardhje nga Roma ose Genova në ishullin italian të Sardenjës mund të kushtojnë dy herë më shumë. Ferrero pagoi 360 euro për një javë në një apartament me katër dhoma gjumi në Sarandë, i cili ishte “bazik, por i bukur”, dhe një pjesë e vogël e asaj që do të paguante në bregdetin italian. Ministri italian i bujqësisë Francesco Lollobrigida – kunati i Melonit, i cili iu bashkua kryeministres në Pulia – kritikoi së fundmi përpjekjet e Shqipërisë për të konkurruar me Italinë në turizëm.

“Është e qartë se ka vende të tjera në bregdetin e Adriatikut që duan të jenë Pulia, por ajo që mund të gjeni këtu nuk mund të gjendet diku tjetër,” tha ai.

Rama ka kërkuar të forcojë lidhjet me Italinë përtej turizmit.

Një fushatë e propozuar “Made in Italia-Albania” synon të ndihmojë Tiranën të nxjerrë çertifikatat e vajit të ullirit dhe verës sipas standardeve të BE-së. “Është një objektiv final,” tha një zëdhënës i ministrisë së bujqësisë. Asnjë datë nuk është konfirmuar për nisjen e tij.

Një zgjerim i shpejtë i resorteve përgjatë bregdetit shqiptar si në fshatin Palasë në Vlorë ka shkaktuar polemika, me shtëpitë


tradicionale që i hapin rrugë hoteleve të mëdha, gjithëpërfshirëse, aksionerët më të mëdhenj të cilëve janë shpesh politikanë.

Ferrero vuri në dukje se apartamenti i tij i pushimeve në Sarandë ishte gjysmë i ndërtuar, si shumë hotele të tjera. “Dukej se ata nuk ishin gati për bumën e turizmit,” tha ai. Punësimi sezonal nga Bangladeshi ka adresuar mungesat e fuqisë punëtore në zhvillimet bregdetare, por në brendësi infrastruktura e vjetëruar po rëndon.

Megjithatë, Ferrero tha se po mendonte të blinte një shtëpi pushimi në bregdetin shqiptar për një të tretën e çmimit, krahasuar me një pronë të ngjashme në vendin e tij. Mosmarrëveshjet mbi pronësinë e tokës mund të përbëjnë një problem, por Ferrero tha se çdo çështje nuk mund të jetë shumë më e keqe se burokracia italiane. Filippo de Miccolis Angelini, i cili drejton një hotel në Pulia, tha se italianët duhet të përfitojnë nga lidhjet e transportit shqiptar të Barit për të rritur ardhjet në Italinë më të varfër jugore. Nga përhapja e turistëve në të gjithë Adriatikut mund të përfitojnë të gjithë, tha ai. “Është e gabuar të dërgosh mesazhin se Shqipëria është e lirë,” tha ai. “Rrëfimi duhet të jetë rreth kulturës, aventurës, autenticitetit.”

Duke iu referuar një rruge të lashtë të ndërtuar nga romakët kur Shqipëria ishte pjesë e perandorisë së madhe, de Miccolis Angelini tha: “E jona mund të jetë një ofertë e përbashkët – ta bëjmë Via Egnatian përsëri të madhe.” / Financial Times

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# Ballkani kualifikohet në 'play-off' të Ligës së Konferencës

PRISHTINË, 17 GUSHT - Kampioni i Kosovës, FC Ballkani e ka kaluar me sukses edhe rrethin e tretë në Ligën e Konferencës, pasi ka shënuar fitore edhe në ndeshjen e kthimit ndaj skuadrës nga Gjibraltari, Lincoln Red Imps. Pas fitores 2:0 në stadiumin "Fadil Vokrri" një javë më parë, skuadra e Ilir Dajës konfirmoi kalimin në fazën e "play-off"-it me fitore si mysafire me shifrat 3-1. Golat për

Ballkanin i shënuan Meriton Korenica (48'), Edvin Kuç (64') dhe Qëndrim Zyba (90'+), derisa golin e vetëm për vendasit e realizoi Juampe Rico (66'). Në "play-off" kampioni i Kosovës me gjasë të mëdha do të përballet me humbësin skuadrën bjelloruse, BATE Borisov, e cila në ndeshjen e parë të rrethit të tretë në Ligën e Evropës ka humbur 5-1 nga Sheriff Tiraspol.



# Rashica: Kur bëjmë shqiponjën, të gjithë e dinë se kush jemi

Stamboll, 17 gusht - Repreruesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, nga Norwich City i është bashkuar skuadrës së madhe turke Beshiktash për 5.5 milionë euro. Ai është pritur me entuziazëm të madh nga tifozët e skuadrës, kurse ka zgjedhur numrin 11 në fanellë. Ai tashmë ka dhënë intervistën e parë për faqen zyrtare të klubit, në të cilën ka folur edhe për simbolin e shqiponjës që lojtarët shqiptarë e bëjnë me duar gjatë çdo festimi të tyre. Rashica u shpreh shumë i lumtur dhe i emocionuar për transferimin në Beshiktash. "Shqiponja është simboli ynë kombëtar, simbol për popullin e Shqipërisë dhe Kosovës. Kur bëjmë shenjën e shqiponjës, ata që na shohin e dinë kush jemi. Kjo vlen edhe për ata që shohin flamurin tonë. I festova golat e mi duke bërë shenjën shqiponje. Ka një kuptim shumë të veçantë për të gjithë ne", ka thënë Rashica. Ish-anëtari i Vitesse, Werder Bremenit dhe Norwich Cityt më pas ka thënë se kalimi te Beshiktashi ishte zgjedhja më e mirë. "Që në momentin e parë që nisëm negociatat me Beshiktashin, ata më respektuan dhe më bënë të



ndieja se më donin shumë. Kjo ishte gjëja më e rëndësishme për mua dhe doja të kthehesha në Turqi, ku isha i lumtur. Mua dhe familjes sime më pëlqeu shumë ky vend dhe kaluam një kohë të mirë këtu. Shumë të mira kanë qenë edhe planet dhe projektet që më ka paraqitur klubi. Më bënë të ndihem sikur më donin, prandaj zgjedha këtë vend. Kam luajtur në këtë stadium vitin e kaluar. Atmosfera ishte shumë e mirë. Mund të them se tifozët në Turqi janë në një nivel krejt tjetër", ka shtuar Rashica.

Ai foli edhe për objektivat e tij me klubin e ri. "Shpresoj se mund të shënoj shumë gola dhe asistime, por nuk ka shumë rëndësi se në çfarë pozicioni luaj, sinqerisht. Përpiqem ta jap kontributin më të mirë për ekipin tim. Nuk janë vetëm gola dhe asistime. Është gjithçka që mund të bëj kur jam në fushë. Më parë kam veshur numrin 11. Është një numër që më pëlqen. Ata thanë se mund ta marr këtë numër. Edhe unë jam i lumtur për këtë. Shpresoj të kemi një sezon të mirë", ka deklaruar Rashica.

# Besa Famgas e nis mbrojtjen e titullit ndaj Vushtrrisë, Istogu kundër Prishtinës

Pejë, 17 gusht - Besa Famgas do ta fillojë në Vushtrri mbrojtjen e titullit të kampionit në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Kështu është përcaktuar me shortin e tërhequr në lokalet e Federatës së Hendbollit të Kosovës. Superliga e hendbollistëve do të përbëhet nga tetë skuadra. Do të luhet sistem i katërfishtë e më pas është plejofi. Ndeshjet e xhiros së parë zhvillohen më 16 e 17 shtator. Pos ndeshjes Vushtrria - Besa Famgas, në xhiron e parë janë edhe ndeshjet Prishtina - Rahoveci, Kastrioti - Trepça e Deçani - Vëllaznimi. Derbi pritet të jetë ndeshja në mes të Prishtinës e Rahovecit. Edicioni 2023/2024 i Superligës së Kosovës në hendboll

(femrat) nis me ndeshje interesante. Shorti për kampionatin e ri është tërhequr të mërkurën në lokalet e Federatës së Hendbollit të Kosovës. Tërheqjen e shortit e ka bërë komisar i garave, Isak Osmani. Kampioni aktual, Istogu, mbrojtjen e titullit e fillon në Prishtinë. Takohet me skuadrën e Prishtinës në xhiron e parë, që zhvillohet më 16 e 17 shtator. Ndeshje tjetër interesante pritet të jetë ajo në mes të Ferizajt dhe Vushtrrisë. Samadrexha - Vëllaznimi, Jusuf Gërvalla - Ulpiana, Kastrioti - Shqiponja janë ndeshjet e tjera të xhiros së parë. Në Superligën e hendbollistëve garojnë dhjetë skuadra. Pas 18 xhirove të stinorit të rregullt zhvillohet faza e plejofit.




# Në katër qytete do të zhvillohet kampi i basketbollit për të rinj

Prishtinë, 17 gusht - Nga 21 deri më 28 gusht nga Kosovo Basketball Heritage Academy dhe Federata e Basketbollit e Kosovës do të organizohet kampi për basketbollistët dhe basketbollistët e reja të

moshës prej 8-16 vjet në katër qytete të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë dhe Gjakovë. Çdo kamp do të përfshihet për fëmijët e moshës 8-16-vjeçare dhe aty do të

përfshihen deri në maksimum 30 kampistë për seancë. Dy seanca të përshtatshme do të zhvillohen në çdo qytet: Në mëngjes nga ora 9:00-12:00 për kampistët e moshës 8-12

vjeçare, pasdite nga ora 13:00-16:00 për kampistët e moshës 13-16 vjeçare. Lojtarët më të mirë nga çdo kamp përkatës i distriktit do të ftohen të marrin pjesë në një All-Star final njëditor, që



do të mbahet në Prishtinë më 25 gusht.

## Guardiola bëhet trajneri i dytë më i trofeshëm në histori

MANCHESTER, 17 GUSHT - Pep Guardiola është pa dyshim një nga trajnerët më të mirë në historinë e futbollit. Ai ka shkëlqyer te Barcelona, Bayern Munichu dhe tani Manchester City, me të cilin fitoi një tjetër trofe të mërkurën mbrëma, teksa mposhti Sevillan për ta fituar

Superkupën e Evropës. Është hera e parë që City e fiton trofeun e Superkupës së Evropës, por Guardiola e ka fituar atë në katër raste. Trofeu i fundit i Superkupës për Guradiolën ishte në vitin 2013, që ishte sezoni i tij i parë në Bayern Munchen. Ai ka një normë fitimi 100 % në

këtë garë. Sipas gazetës "Sport", Superkupa e Evropës është trofeu i 36 i karrierës së Guardiols si trajner, që do të thotë se ai tani është trajneri i dytë më i suksesshëm për sa iu përket trofeve, duke kaluar Mircea Lucescu, i cili ka 35. Ai është ende prapa menaxherit legjendar të Manchester

Unitedit, Sir Alex Ferguson, i cili fitoi 49 tituj gjatë karrierës së tij të shkëlqyer. Megjithatë, ish-trajneri i Barcelonës, Guardiola, ka të ngjarë ta thyejë edhe atë rekord në të ardhmen, pasi çdo sezon po fiton trofe. Trajneri katalunas ka fituar me Cityn trofe çdo 27 ndeshje.



## Muja në shtator debutoon për Shqipërinë

TIRANË, 17 GUSHT - Arbnor Muja është lojtari më i ri i Kombëtares shqiptare. "Panoramasport" mëson se 24-vjeçari është pjesë e listës së Silvinhos për dy ndeshjet e muajit shtator që ekipi kombëtar do të luajë në transfertë ndaj Çekisë më 7 shtator dhe me Poloninë në "Air Albania" tri ditë më vonë. Sulmuesi i krahut të djathtë, i cili luan për Antverpin në Belgjikë, ka tërhequr vëmendjen e trajnerit brazilian, që e ka në listë për grumbullimin e radhës, i cili pritet të nisë më 29-30 gusht. Muja, i cili është thirrur nga Kosova, por nuk ka zbritur për asnjë minutë në fushë, ka zgjedhur ta përfaqësojë Shqipërinë, tekta në rolin e tij duhet të konkurrojë Jasir Asani, një lojtar i rekrutuar po nga Silvinho këtë vit. Fillimisht ka qenë ndihmësi i Silvinhos, Pablo Zabaleta, ai që ka shkuar dhe ka takuar nga afër Arbnor Mujën dhe e ka bindur të kalojë te Kombëtarja shqiptare. Paraqitjet e mira në Belgjikë, ku brenda një sezoni ai fitoi titullin kampion, Kupën dhe Superkupën me Antverpin, rritën më shumë shanset që Silvinho të gjejë një vend për të. Edhe pse dëshira ishte që Muja të vinte që



në ndeshjet e qershorit, pengesë u bë pasaporta shqiptare, të cilën lojtari i lindur në Mitrovicë nuk e kishte. Ndërkohë, mësohet se ditën e martë ai ndodhej në Shqipëri dhe ka aplikuar për marrjen e nënshtetësisë, teksa menjëherë është kthyer në Belgjikë për të vijuar përgatitjet me klubin e tij Antwerp, pasi përpara ka "play off"-in e Ligës së Kampioneve. Kështu që kjo problematikë u kalua dhe sulmuesi do të jetë gati për Shqipërinë në muajin shtator dhe nuk do të ketë asnjë pengesë tjetër. Më parë ai

është thirrur nga Kosova në muajin mars, por nuk ka debutuar me ekipin e parë dhe në karrierën e tij numëron 6 ndeshje me Kosovën U-21. Ndërkohë, Arbnor Muja, para se të transferohej në kampionatin belg, luante për Dritën në Kosovë, ku shkëlqeu në ndeshjet kualifikuese të Ligës së Evropës. Sakaq, sulmuesi i djathtë ka qenë edhe pjesë e Skënderbeut në Superiore, ku me korçarët ka luajtur vetëm 11 ndeshje dhe ka shënuar 2 gola. Në shtator do të nisë një kapitull të ri, atë me fanellën kuqezi.

## Futbollisti më i mirë i UEFA-s, Messi, përballë dy lojtarëve të Cityt

Cyrih, 17 gusht - UEFA ka shpallur listën e ngushtë të futbollistëve që garojnë për lojtarin më të mirë të UEFA-s për sezonin e kaluar 2022-2023. Tre të nominuarit për këtë çmim individual janë tre lojtarë: Kevin De Bruyne, Erling Haaland dhe Leo Messi. Dy lojtarët e Manchester Cityt dhe ish-futbollisti i PSG-së do të garojnë për këtë çmim, që do të jepet më 31 gusht, në Monte Carlo. Tre trajnerët që do të garojnë për çmimin e trajnerit më të mirë janë Pep Guardiola (Manchester City), Simone Inzaghi (Inter) dhe Luciano Spalletti (Napoli). Këto çmime marrin parasysh sezonin e zhvilluar si në klube ashtu edhe në ekipin kombëtar të lojtarëve që kanë luajtur në futbollin evropian.



Po më 31 gusht, datë kur do të zhvillohet mbrëmja gala e UEFA-s, do të hidhet shorti për fazën e

grupeve të Ligës së Kampioneve, Ligës së Evropës dhe Ligës së Konferencës.

### SHKURT

Manaj, afër transferimit në Sivasspor

Rey Manaj më në fund gjen skuadër. Sipas raportimeve të medieve spanjolle, sulmuesi shqiptar do të bashkohet me Sivassporin, me të cilin do të firmosë kontratë trevjeçare. Sulmuesi i kombëtares shqiptare do të udhëtojë të premten drejt Turqisë dhe do t'u nënshtrohet analizave mjekësore për të firmosur më pas kontratën dhe për t'u zyrtarizuar te klubi i ri. Rey Manaj shkon me parametra zero te Sivasspori, ndërsa që prej muajit shkurt, pas ndërprerjes së bashkëpunimit me Watfordin, ishte lojtar i lirë.

Kane tregon se si Tucheli e bindi t'i bashkohet Bayernit

Sulmuesi i Bayern Munchenit, Harry Kane, ka folur për bisedën me trajnerin e skuadrës, Thomas Tuchel, para se t'i bashkohej Bayernit. Futbollisti 30-vjeçar iu bashkua radhëve të gjigantëve bavarezë më 12 gusht. Transferimi i kushtoi klubit gjerman 100 milionë euro, pa përfshirë bonuset. "Tuchel luajti një rol të rëndësishëm në kalimin tim këtu. Ai ndau vizionin e tij, tregoi se çfarë pret nga ekipi, cili do të jetë roli im, si duhet të dominojë Bayerni në fushë. Kaluam shumë mirë", ka thënë Kane, i cili debutoi në skuadrën e re në ndeshjen e Superkupës së Gjermanisë kundër RB Leipzigut, e cila përfundoi me humbjen 0-3.

Ansu Fati dëshiron të largohet nga Barça

Sulmuesi Ansu Fati ka shpallur dëshirën për t'u larguar nga Barcelona. Kështu raporton e përditshmja spanjolle "AS". Pavarësisht që Fati synonte pozitën e titullarit, trajneri Xavi Hernandez nuk e sheh të tillë. Në ndeshjen hapëse të La Ligas ndaj Getafes trajneri përdori fillimisht Abden, më pas Lamine Yamal dhe vetëm në zëvendësimin e tretë hyri në lojë Ansu Fati. Gjithashtu, Barcelona po kërkon edhe përforsime për sulm gjë që tregon se Fati nuk shihet si i rëndësishëm në klubin nga "Camp Nou". Kohë më parë është përfolur se talenti 20-vjeçar mund t'i bashkohet PSG-së ku trajner është Enrique.

Arnautoviçi rikthehet pas 13 vjetësh në Inter

Interi arriti ta zyrtarizonte sulmuesin më të ri, Marko Arnautoviç. Për të ky është një rikthim në këtë klub, pasi 13 vjet më parë luante me ngjyrat zikaltër. Interi arriti ta gjente marrëveshjen me Bolognan për shifrën 10 milionë euro në total. Sulmuesi austriak pati një pritje madhështore e të ngrohtë nga tifozët e Interit, sidomos nga ultrasit e "Curva Nord", të cilët e pritën jashtë zyrave ku lojtari ishte duke kryer testet mjekësore të mërkurën. Pasi firmosi kontratën e tij, Arnautoviçi u fut në dhomën e trofeve të klubit, madje lëshoi edhe një mesazh për të gjithë tifozët zikaltër. "Përhëndetje tifozë të Interit! Jam kthyer. Jam shumë i lumtur të jem përsëri këtu. Mezi pres t'ju shoh në 'San Siro' dhe t'i takoj shokët e mi të skuadrës. Forza Inter!", është shprehur Arnautoviçi.

## Neymar: Kampionati i Arabisë Saudite po rritet, Ronaldo është pionieri

Pas Cristiano Ronaldos, Benzemas dhe shumë të tjerëve, në kampionatin e Arabisë Saudite u transferua edhe Neymari, që firmosi me klubin Al-Hilal. Pas zyrtarizimit tek Al-Hilali, ishi i Barcelonës dhe Paris

Saint-Germainit u shpreh se kampionati arab po rritet çdo ditë e më shumë, ndërsa shtoi se Cristiano Ronaldo është pionier i gjithë kësaj çfarë po ndodh sot me futbollin. "Jam i emocionuar për të bërë histori në Al Hilal. Jam

imotivuar nga sfidat. Kurgjen një sfidë si kjo, është mirë për veten tënde. Saudi Pro Liga po zhvillohet gjithnjë e më shumë. Ata po ndryshojnë shumë. Ata kanë bërë shumë afrime. Ata do të jenë shumë konkurrues, aq më

tepër me këto nënshkrime. Shpresoj që klubi të mund të bëjë një fushatë të madhe. Mendoj se konkurrenca është e rëndësishme, prandaj erdha këtu. Cristiano Ronaldo ishte pionieri i gjithë kësaj. Të gjithë e

quanin të çmendur dhe sot ai sheh kampionatin e Arabisë Saudite duke u rritur gjithnjë e më shumë. Unë, po ashtu, jam këtu për ta ndihmuar kampionatin të rritet gjithnjë e më shumë", ka thënë Neymari.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA  
ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 651/1  
Dt: 17.08.2023

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017, Vendimi (MASHTI) nr. 01B/027 të dt. 03.03.2023, Vendimi (MASHTI) nr. 326/01B të dt. 28.07.2022, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## Ri-SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira dhe zëvendësim në Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, dhe Qendrën e Kompetencës në Prizren për vitin shkollor 2023/2024

Niveli	Institucioni/Shkollë	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vend i lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë	Malishevë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Instalues i ngrohjes me klimatizim dhe ujësjellës e kanalizim (20 orë mësimore);	Zëvendësim deri në kthim e mësimdhënës nga pushimi i lehonisë
SHML	Qendra e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi”, në Prishtinë	Prishtina	Dy (2) Instruktor /e për modulet profesionale të profilit “Esteticient/e”, me nga 20 orë;	Vend i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës	Prizren	Një (1) Instruktor /e për modulet profesionale të profilit “Esteticient/e”, 10 orë;  Një (1) Instruktor /e për modulet profesionale të profilit “Floktari”, 10 orë	Vend i lirë  Vend i lirë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silllet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t’i kryejë detyrat që mund t’ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore tënxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrë të duhur ndaj

tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.

- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MASHTI), niveli i 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës në arsim (nëse ka);
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t’i kryejë detyrat që mund t’ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MASHTI), niveli i 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lart;
- Për modulet e praktikës profesionale të profilit “Esteticient/e”, përparësi kanë kandidatët me përgatitje/ kualifikim Bachelor, niveli i V ose ekuivalent, me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në fushën përkatëse;
- Për modulet e praktikës profesionale të profilit “Floktari”, përparësi kanë kandidatët me përgatitje/ kualifikim Bachelor, niveli i V ose ekuivalent, me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në fushën përkatëse;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

### Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, dhe Qendrën e Kompetencës në Prizren.
- Aplikacionit duhet t’i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t’i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Subways” SH.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Egzon Hajdari, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810005290 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Subways” D.O.O. Gnjilane, sa vlasnikom Egzon Hajdari, donelo odluku o prestani rada sa nr. 810005290 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Subways” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Egzon Hajdari, has come to the decision to quit its business: 810005290 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gëzim Kastrati nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e shkollës së mesme Ekonomike “Kadri Kusari”.

- Maklidon Neziri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike “Nexhmedin Nixha”.

- Efe Muzbeg shpall te pavlefshme dëftesat e kl I- V të SHFMU “Emin Duraku” Prizren.

- Samira Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 10, 11, 12,13 si dhe diplomën e gjimnazit “Asllan Berisha”.

- Sejdi Pulaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Florim Gaxherri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e vitit 10,11,12 të gjimnazit “Hajdar Dushi”.

- Murat Nimani, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme “ARKITEKT SINANI” ish-shkolla (Boris Kidriç).

- Avdullah Olloni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”.

- Shend Prekazi B.I, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 811444679.

- Flurije Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 5, 6, 7, 8 të shkollës fillore “Shaban Golaj”.

- Lulzim Xhafa, shpall të pavlefshme diplomën e shkollë së mesëm “Hasan Prishtina”.

- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Agush Zenuni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Nexhmedin Nixha, Gjakovë.

- Leona Dolki nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Luan Çarkagjija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 9, 10, 11, 12 dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA  
Since 1909

Columbus, Georgia, USA  
0.5L